



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.322/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1100 (*njëmijë e njëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, me datën 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga organizata Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik AKR me datë 22.10.2017, në afërsi të shkollës fillore “Migjeni” e njëjta Qendër e Votimit QV, në Mitrovicë, kanë vendosur mbi dy korsitë e rrugës bilbordin e kandidatit Agim Bahtiri për kryetar të Komunës së Mitrovicës.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është thyer heshtja zgjedhore, dhe nga ky veprim është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1 pika a) dhe b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.10.2017, subjekti politik AKR, ka theksuar se nga momenti i pranimit të ankesës, zyrtarër përgjegjës të fushatës zgjedhore të AKR-së, kanë dalë në teren dhe e kanë larguar banerin nga vendi i shkeljes së supozuar. Më tutje thekson se, vendosja e mjetit është bërë pa qenë në dijeni strukturat partiake të subjektit politik AKR.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat e lëndës, në kuptim të dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 të LZP-së, konstatoj se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të provës, fotografis të bashkangjitur në ankesë ka vlerësuar në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik, Aleanca Kosova e Re (AKR), Agim Bahtiri, gjatë heshtjes zgjedhore në afërsi të shkollës fillore “Migjeni” e njëjta Qendër e Votimit QV, në Mitrovicë, kanë vendosur mbi dy korsitë e rrugës bilbordin e kandidatit Agim Bahtiri për kryetar të Komunës së Mitrovicës.

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që këto veprime paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët, të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se : 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 118 pika dhe nenit 120. të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 322/2017 më datën 22.10.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.